VËSHTRIM

Qiproja, në rrugë drejt njohjes së plotë të pavarësisë së Kosovës

James Ker-Lindsay – LSE

Nga të gjitha aspektet, ishte ajo një fotografi e jashtëzakonshme. Më 24 shtator, shefi i stafit të kryeministrit të Kosovës ka postuar në "Twitter" një fotografi të kryeministrit Hashim Thaçi dhe ministrit të Jashtëm, Enver Hoxhaj, duke ngrënë mëngjes me Ioannis Kasoulides, ministër i Jashtëm i Qipros, në margjinat e takimit të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së në New York. Për një zyrtar të lartë të një shteti që për tridhjetë vjet ka tentuar të shmangë njohjen e Republikës së vetëshpallur turke të Qipros Veriore (TRNC) dhe që kishte një qëndrim skajshmërisht kundër shpalljes unilaterale të pavarësisë së Kosovës, ishte ky një zhvillim i jashtëzakonshëm. Sidoqoftë, në kontekstin e zhvillimeve më të gjera dhe sinjaleve të fundit se politikat e jashtme qipriote po rindërtohen, është ky në fakt një zhvillim më pak befasues se sa disa do të mund të besonin.

Ndryshimi i pikëpamjeve në mesin e pesëshes së BE-së

Që kur Kosova shpalli pavarësinë, në shkurt të vitit 2008, vendi është dëshmuar të jetë një prej çështjeve më ndarëse të politikave të Jashtme përbrenda Bashkimit Evropian. Në njërën anë ishte shumica e 28 shteteve anëtare që kanë zgjedhur ta njohin atë. Të renditur kundër tyre janë pesë anëtaret – Qiproja, Greqia, Romania, Sllovakia dhe Spanja – të cilat kundërshtojnë me këmbëngulje që të njohin pavarësinë e plotë të Kosovës si një shtet sovran.

Sidoqoftë, kjo situatë tani duket se po ndryshon. Derisa Spanja mbetet kundërshtare e vendosur e njohjes, veçanërisht tani që Katalonia po bëhet gjithnjë e më e zëshme në kërkesat e saj për pavarësi, ka sinjale të qarta nga Rumania, Sllovakia dhe Greqia për rishqyrtim të qëndrimeve.

Gjatë muajve të fundit, Victor Ponta, kryeministër i Rumanisë, haptazi ka deklaruar se Bukureshti duhet të lëvizë drejt njohjes së Kosovës. Edhe pse një gjë e tillë nuk do të ndodhë në një të ardhme të afërt, duke e pasur parasysh faktin se njohja kundërshtohet fuqimisht nga presidenti Traian Basescu, tani duket të jetë vetëm çështje kohe kur Rumania do të zgjedhë t'i bashkohet shumicës së BE-së. Njësoj kështu, edhe opinioni në Sllovaki po ndryshon. Është më se e ditur se Miroslav Lajcak, ministër i Jashtëm sllovak, është i interesuar që shteti i tij ta njohë Kosovën dhe bën fare pak tentime që ta fshehë këtë qëndrim në takimet e tij me zyrtarë nga Kosova. Në këtë rast, megjithatë, situata është disi më e komplikuar, për shkak të një rezolute kundër njohjes.

Sido që të jetë, duket sikur kjo rezolutë mund dhe do të zmbrapset; sidomos nëse një apo dy nga pesë shtetet jonjohëse ndryshojnë qëndrim. Në të vërtetë, shefi i Komitetit për Marrëdhënie me Jashtë tashmë ka sinjalizuar vullnetin e tij për të qenë një zë më kumbues për qëndrimin e shtetit karshi Kosovës.

Ndërkohë, Greqia po lëviz gjithnjë e më afër njohjes së plotë. Në fakt, si një prej pesë shteteve jonjohëse, vendi tashmë ka marrëdhëniet më të ngushta me Prishtinën. Në mars të këtij viti, ministri i atëhershëm i Punëve të Jashtme, Dimitris Avramopoulos, e ftoi ministrin e Jashtëm Hoxhaj në takime formale në Ministrinë e Jashtme në Athinë, dhe me ta bërë këtë ai e përdori titullin e tij zyrtar; një zhvillim ky i rëndësishëm pasi që posti i ministrit të Jashtëm është një pozitë që ndërlidhjet ngushtë me shtetësinë.

Privatisht, diplomatët grekë shkojnë madje edhe më tutje dhe pranojnë se Athina është gati që ta njohë Kosovën. Siç shpjegojnë ata, gjëja e vetme që e ndalon Greqinë nuk është miqësia tradicionale e shtetit me Serbinë, e cila është luhatur pas mbështetjes që Beogradi i ofroi Maqedonisë për çështjen e emrit, por shqetësimit rreth asaj se si kjo gjë do të kuptohej nga qipriotët. Mirëpo edhe kjo mbase tani është një çështje më pak shqetësuese; për shkak se jo të gjithë zyrtarët qipriotë kanë thënë se e kuptojnë pozitën në të cilën Greqia e gjen veten përballë partnerëve të vetë evropianë dhe pse vendi do të dëshironte të përfitonte sado pak dashamirësi, duke e njohur Kosovën.

Prandaj ka gjithnjë e më shumë të ngjarë që Athina të ndryshojë politika, Me gjithë mohimet e vazhdueshme se do ta bëjë një gjë të tillë.

Një drejtim i ri në politikat e Jashtme të Qipros

Fakti se Qiproja ndien simpati për qëndrimin grek nuk do të thotë kryekëput se vendi është i gatshëm që të ndryshojë kundërshtimin e vet të fortë për pavarësinë e Kosovës. Në të vërtetë, të paktën deri para pak kohësh, vendi është parë si anëtari më ekstrem nga të pestë jonjohës. Siç deklaroi presidenti Papadopoulos pak pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, "Qiproja nuk do ta njohë Kosovën edhe nëse Serbia e bën këtë". Sidoqoftë, fakti se qëndrimet po ndryshojnë në Sllovaki dhe në Rumani, e po ashtu edhe në Greqi, kërcënon ta vërë Qipron në një pozitë edhe më të vështirë të të lënit në një minoritet prej dy shtetesh që janë kundër Kosovës. Nuk është sekret se Nikozia po përpiqet me të gjitha forcat që të ngrejë reputacionin e vet si "një shtet anëtar që është rast në vete".

Edhe pse ndarja e vazhdueshme e ishullit mbetet një "çështje kombëtare", zyrtarët qipriotë janë të interesuar të shprehin se Qiproja tani është diç më shumë se "problem i brendshëm". Për shembull, ishte një gjë më se e dukshme se çështja e Qipros është mbajtur qëllimisht jashtë agjendës, gjatë gjysmës së dytë të Presidencës qipriote të Bashkimit Evropian, më vitin 2012.

Ndërkohë, zgjedhja e një qeverie të re të qendrës së djathtë, në shkurt të këtij viti, ka sjellë një ndryshim madhor në orientimin e përgjithshëm të politikave të jashtme të vendit. Duke qenë për një kohë të gjatë e fuqishmja e Lëvizjes së të painkuadruarve dhe tradicionalisht e afërt me Rusinë, nën presidentin Anastasiades dhe ministrin e Jashtëm Kasoulides, i cili ishte anëtar i Parlamentit Evropian përpara se të kthehej në Qipro për ta marrë portofolin e marrëdhënieve të jashtme (të cilin e mbante edhe më herët), qenë hedhur hapa të rëndësishëm për ta rreshtuar Qipron sa më afër Perëndimit. Mbase shenja më e dallueshme e kësaj ishin bisedimet e anëtarësimit në Partneritetin e Paqes të NATO-s, duke e çuar kështu vendin në fund drejt anëtarësimit të plotë; një politikë kjo që do të ishte e paimagjinueshme madje vetëm pesë vjet më parë.

Problemi i angazhimit

Për shkak të të gjitha këtyre arsyeve, çdo vendim për të zbutur politikat e mëparshme karshi Kosovës, nëse kjo është ajo që vërtetë po ndodh, do të ishte më pak befasuese se sa mund të duket fillimisht. Për më tepër, ekzistojnë shenja se opinioni më i gjerë publik dhe politik mund po ashtu të zbutet për sa i përket çështjes së Kosovës; jo pse kjo ka qenë ndonjëherë një çështje madhore për publikun.

Në mënyrë të veçantë, fotografia kalon fare e pavërejtshme në shtypin qipriot. E as që ndonjë prej partive të tjera politike është zotuar që ta ngrejë çështjen. (Kjo mbase ndihmon po ashtu që DIKO, partia që në përgjithësi shihet si më ekstremja për çështjen e Qipros, të bëhet një anëtare e koalicionit qeverisës). Në këtë aspekt, nëse takimi i mëngjesit ishte një pikënisje për ndryshim politikash, ai sigurisht se nuk është mbyllur me kaq.

Nëse, në të vërtetë, ai ishte një tentim për të testuar atmosferën, atëherë mungesa e përgjithshme e reagimit do të sugjeronte se do të mund të ketë hapësirë për qeverinë e ardhshme që tani t'i çojë gjërat më tutje. Pyetja e madhe që tani shtrohet është ajo se çfarë duhej, apo mund, të vijë më pas? Një politikë e angazhimit konstruktiv me Kosovës, në përputhje me qëndrimet në Greqi dhe Sllovaki, është një shteg i dukshëm që qartazi do të sinjalizonte se Qiproja tani është e gatshme të jetë më konstruktive për çështjen e Kosovës.

Sido që të jetë, shtigjet nuk janë aq të hapura për Qipron sa janë për të tjerët. Në të vërtetë, ekziston një argument i fortë se nëse Qiproja nuk dëshiron të ecë përpara me këtë çështje, atëherë duhet të shkojë edhe më tutje. Sado e rastësishme që të mund të tingëllojë, Qiproja do të bënte shumë më mirë sikur të ushtronte presion për njohjen e plotë, në vend se thjeshtë të rriste angazhimin.

Arsyeja që fshihet prapa kësaj është relativisht e thjeshtë. Një prej shqetësimeve kyç që Nikozia ka gjatë gjithë këtyre viteve nuk është njohja e republikës turke të Qipros Veriore, por legjitimimi gradual i tij; një proces i "Tajvanizimit", kur shtetet bashkëveprojnë gjithnjë e më shumë me turqit e Qipros mirëpo nuk shkojnë aq tutje sa t'i njohin në mënyrë të plotë. Me të folur me diplomatët qipriotë, kjo çështje shfaqet kohë pas kohe si një shqetësim kyç i tyre. Një drojë e tillë është ushqyer nga përpjekjet e ndryshme për të përfunduar izolimin e turqve të Qipros pas vendimit të tyre, më 2004, që të votojnë në favor të një plani të ribashkimit të sponsorizuar nga OKB-ja (Plani Annan), i cili është hedhur poshtë me shumicë votash nga komuniteti grek i Qipros.

Për më tepër, gjatë viteve të fundit, ka pasur thirrje të shtuara nga Organizata e Bashkëpunimit Islamik (IOC) që shtetet myslimane të ndërmarrin hapa për "forcimin e solidaritetit" të "shtetit të turqve të Qipros". Me t'u angazhuar me Kosovën, Qeveria qipriote rrezikon t'u dërgojë sinjale shteteve të tjera të botës se një formë e tillë e angazhimit pa njohje është në fakt e pranueshme. Në të vërtetë, kjo gjë e lë vendin të hapur ndaj akuzave për hipokrizi, nëse tenton të dënojë të tjerët për bashkëveprim me turqit e Qipros në të njëjtën mënyrë sikurse ajo vetë do të angazhohej në Kosovë.

Njohja: e pamundur në dukje?

E përballur me këtë, vendi mund ta ketë më të lehtë të mbahet me politikat e mëparshme, me gjithë izolimin në rritje që ato do të nënkuptonin. Në mënyrë alternative, Qeveria qipriote mund të zgjedhë të shkojë drejt një shtegu krejtësisht ndryshe dhe të largohet sa më shumë nga njohja e Kosovës. Derisa kjo ide mund të duket ekstrem e largët nga ajo e para, është realitet që një vendim i tillë mund të mos jetë aq problematik apo aq i vështir sa mund ta imagjinoni. Ani pse Qiproja për një kohë të gjatë e ka kundërshtuar njohjen, me rëndësi është se ajo kurrë faktikisht nuk e ka hedhur poshtë argumentin e "rastit unik", mbi të cilin Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe shumica e shteteve të Bashkimi Evropian i kanë bazuar vendimet e tyre për ta njohur Kosovën; vetëm të nënvizoj se Kosova nuk mund të jetë në precedent për Qipron.

Njësoj kështu, pozita e saj nën të drejtën ndërkombëtare mbetet e fortë. Për dallim prej Kosovës, shpallja e pavarësisë së turqve të Qipros ishte dënuar zyrtarisht nga Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara (me rezolutën 541), e cila ka bërë thirrje që asnjë shtet të mos e njohë Republikën turke të Qipros së Veriut. Ngjashëm kështu, edhe opinioni këshillues i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (GJND) mbi Kosovën, në qershor të vitit 2010, ka riafirmuar se shpallja e pavarësisë së turqve të Qipros ishte në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare. Në fund, me më shumë se gjysmën e shteteve anëtare të OKB-së që tani e njohin Kosovën, Qiproja mund në mënyrë të barabartë të argumentojë se batica qartazi është duke rrjedhur në një drejtim të sigurt dhe të pakthyeshëm. Duke e njohur Kosovën, Qiproja – sikurse edhe shtetet e tjera që përballen me kërcënimin separatist, por që kanë zgjedhur të njohin Kosovën, siç është Kanadaja – në fakt do të dërgonte një mesazh shumë të qartë se nuk sheh ndonjë lidhje ndërmjet situatës së Kosovës dhe të vetë asaj.

Mbase gjëja më e rëndësishme nga të gjitha, nëse Qiproja vendos ta njohë Kosovës, është se ajo nuk ka të ngjarë të përballet me ndonjë dënim apo përbuzje të madhe ndërkombëtare, të paktën jo prej aty ku mendon se do të ketë. Siç vihet në dukje, më shumë se gjysma e shteteve anëtare të OKB-së tashmë kanë vepruar kësisoj. Ato nuk do të thonë asgjë të pafavorshme. Sa për gjysmën e mbetur, shumica do të vrasin kokat për të bërë ndryshime të tilla edhe vetë. Ndërkohë, për sa u përket partnerëve perëndimorë të Qipros, të cilët për një kohë të gjatë kanë insistuar për një pranim më të gjerë ndërkombëtar të Kosovës, kjo definitivisht do të jetë çështje që është më mirë të ndodhë vonë, sesa kurrë.

Qartazi, ato nuk do ta turpërojnë Qipron për këtë. Në të vërtetë, mund të pritet pikërisht e kundërta. Ata jo vetëm se do të ishin të interesuar të riafrimojnë edhe njëherë se dy situatat janë krejtësisht ndryshe prej njëratjetrës, por Qiproja edhe do të mund të shpërblehej për ndryshimin e qëndrimit. (Veçanërisht pasi kjo gjë do ta niste pothuajse sigurt zinxhirin e reagimit me njohje nga grekët, rumunët dhe më pas sllovakët; apo mund të organizohet në tandem me një apo të gjitha ata). Me bisedimet e reja të sponsorizuara nga OKB-ja për ribashkimin të Qipros që duken në horizont, një vendim për njohjen e Kosovës mund të sillte shpagim të rëndësishëm në kohëra vendimtare.

Hapat e ardhshëm

Natyrisht, është me rëndësi të ceket se nuk ka asgjë konkrete në këtë fazë. Një takim mëngjesi nuk i ndryshon politikat përnjëherë. Sidoqoftë, vetë vendimi i ministrit të Jashtëm qipriot që të ulet në një hapësirë publike me kryeministrin dhe ministrin e Jashtëm të Kosovës është një zhvillim me rëndësi të madhe, duke pasur parasysh qëndrimin ekstrem të mëparshëm të adoptuar nga Nikozia. Në aspektin e ndryshimit të qëndrimeve të jo-njohësve të tjerë të BE-së dhe synimit të qartë të Qeverisë qipriote për të marrë një kah të ri në politikat e saj të jashtme, ky takim mund të jetë një sinjal bukur i qartë se diçka është në përgatitje e sipër. Nëse po, dhe po aq konstruktive sa mund të duket, atëherë ekziston një argument shumë i fortë se hapi i ardhshëm i angazhimit duhet të shihet si një kërcim gjigant drejt njohjes.

(James Ker-Lindsay është një partner i lartë i hulumtimeve të "Eurobankës" për politikat e Evropës Juglindore në Shkollën e Ekonomisë në Londër. Hulumtimet kryesore të tij kanë të bëjnë me konflikte, proceset e paqes, ndarjet dhe njohjet. Ai është autor i librave "Kosova: Rruga drejt shtetësisë së kontestuar në Ballkan", "Problemi i Qipros: Çfarë duhet të dinë të gjithë" dhe i "Politika e Jashtme e një ndarjeje të kundërshtuar: Parandalimi i njohjes së shteteve të kontestuara". Ky tekst është marrë me leje te autorit nga blogu për Politikë Evropiane i Shkollës Londineze të Ekonomisë - LSE EUROPP).

KOHA DITORE

E përditshme e pavarur informative

Themelues: Veton SURROI
Numri i parë u botua më 31 mars 1997

Pronare dhe botuese:
Flaka SURROI

Gazeta redaktohet nga kolegjiumi:
Kryeredaktor: Agron BAJRAMI
Zv. kryeredaktore: Valbona MEHMETI
Ndihmëskryeredaktore:
Brikenda REXHEPI
Redaktor përgjegjës: Elmaz ISUFI

Zenun ÇELAJ (**Portali**),
Bekim KUPINA (**Kosovë**),
Visar LOCI (**Sport**),
Granit KURTI (**Kulturë**),
Nita LLESHI & Arbana MJEKIQI (**Botë**),
Sami KÇIKU (**Mes për Mes**),
Visar DOMI & Liridon MJEKIQI
(**Qendra Grafike**),
Alban BUJARI & Driton PAÇARADA
(**Fotografi**)

Telefonat e redaksisë:
038/249-104
249-105; 243 875
Fax: 038/249-106

Fahu postar 202
e-mail: redaksia@kohaditore.com
Marketing: tel & fax: 038/248-880
e-mail: marketing@kohaditore.com
marketing@koha.net

Xhirollogaria:
ProCredit - 1110086926000189
NLB - 1701001010645930
TEB - 2011000000081423
Raiffeisen - 1501001002095874
BKT - 1901217632031247
B. Ekonomike - 1401000000933831
BpB - 13002712000030870

Shtypet në Shtypshkronjën "KOHA"
tel. 044/126 367

Marketingu për botimin ndërkombëtar:
Koha Ditore
Era Press GmbH
Sihlstrasse 38
CH-8001 Zürich

Tel.+41(0) 43 497 32 80
koha@erapress.ch

Konto në Zvicër:
Credit Suisse
Konto: 992472-01-2
IBAN: CH85 0483 5099 2472 0100 2
BIC/SWIFT: CRESCHZZ80A

Druck:
SM Druckhaus GmbH
D-633303 Dreieich

Nuk lejohet ribotimi i pjesshëm apo i plotë, në cilindo medium, i cilitdo material për të cilin KOHA Ditore i mban të drejtat e rezervuara, pa autorizimin paraprak me shkrim nga KOHA Ditore

Dorëshkrimet dhe fotografitë nuk kthehen

Rubrika e përhershme "Shprehu" është krijuar si hapësirë e "Kohës ditore" për të botuar letrat, opinionet, reflektimet dhe reagimet e lexuesve dhe qytetarëve. Të gjitha shkrimet nuk duhet të jenë më të gjata se 500 fjalë. Redaksia mban të drejtën për të redaktuar e shkurtuar, si dhe mos botuar ato shkrime që nuk i përmbahen etikës. Opinionet e shprehura në këtë rubrikë nuk përfaqësojnë qëndrimet e redaksisë.